



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 745 Prot.

Tiranë, më 24.04.2025

URDHËR

Nr. 46, Datë 24.04.2025

PËR

CAKTIMIN E DATËS 2 MAJ 2025 DITË PUSHIMI NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në mbështetje të nenit 87 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 3 dhe 39 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 145, datë, 10.03.2021 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”si dhe nenit 27, pika 2 të Statutit të Universitetit të Arteve,

URDHËROJ:

1. Caktimin e datës 2 Maj 2025, ditë pushimi për studentët dhe personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ të Universitetit të Arteve.
2. Përfshirje nga pika 1 e këtij urdhri bën personeli i angazhuar në salla.
3. Zëvendësimi i kësaj dite pune dhe mësimi, për studentët dhe personelin sipas pikës 1, do të bëhet në një datë tjetër dhe do të njoftohet në një moment të dytë.
4. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore IS/P-A si dhe Sektori i Teknologjisë së Informacionit të Universitetit të Arteve ngarkohen me detyrën e njoftimit të këtij urdhri.
5. Ky urdhër të publikohet në faqen zyrtare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


Prof. Dr. Erald Bakalli